

URDHËR
Nr. 259, datë 3.5.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 685, DATË 19.12.2019, “PËR MIRATIMIN
E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE SHËNDETËSORE DHE
KARANTINORE TË DISA SPECIE ZOGJSH”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 2, të nenit 51, nenit 72 dhe germës “c” të nenit 129, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në urdhrin nr. 685, datë 19.12.2019, “Për miratimin e rregulloreve për përcaktimin e kushteve shëndetësore dhe karantinore të disa specieve zogjsh”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

Në Rregulloren “Për përcaktimin e kushteve shëndetësore dhe karantinore të disa specieve zogjsh”, bëhen këto ndryshime si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 8, shkronja ‘b’ ndryshon me këtë përmbajtje:

“b) Të njoftojë pikën e inspektimit kufitar 24 orë para datës së mbërritjes së ngarkesës në mënyrë elektronike ose duke u paraqitur fizikisht importuesi apo përfaqësuesi i ngarkesës në fjalë dhe duke plotësuar në PIK dokumentin veterinar për importin dhe tranzitin (DVIT) në territorin e vendit tonë”.

Neni 2

Në nenin 10, shkronja “b” ndryshon me këtë përmbajtje:

“b. Personi përgjegjës për objektin e miratuar të karantinës ose qendrës së destinacionit duhet të njoftojë brenda 1 dite pune nga data e mbërritjes së ngarkesës, veterinerin zyrtar përgjegjës të miratimit të objektit karantinor ose qendrës në vendin e destinacionit të mbërritjes së dërgesës”.